

SH.A UJËSJELLËS-KANALIZIME, TIRANË
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik “Kronos Konstruksion sh.p.k me me nr. NIPT-i K41416033P, me administrator Z. Vasil Jovani, me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta” pranë ish Ekspozitës Shqipëtare”, Tiranë

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksioni i dy linjave të qendrës (Nga rruga Todi Shkurti deri te Pedonalja)” Loti II nga piketa “17” deri te piketa “33”

Fondi Limit: 55,613,884 (pesëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjiellës-Kanalizime, Tiranë.

Kohëzgjatja e kontratës: 60 ditë duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Data e zhvillimit të tenderit është: 22/06/2016 Ora: 09:00.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr 22 datë 06/06/2016.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|--|-----------------|
| 1. Operatori ekonomik “ SENKA ” sh.p.k
Vlera: nuk ka paraqitur ofertë ekonomike | NIPT J94808405Q |
| 2. Operatori ekonomik “ SHENDELLI ” sh.p.k
Vlera: nuk ka paraqitur ofertë ekonomike | NIPT K07924803N |
| 3. Operatori ekonomik “ BEAN ” sh.p.k
Vlera: 51,188,491 (pesëdhjetë e një milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH. | NIPT J72510445Q |
| 4. Operatori ekonomik “ Kronos Konstruksion sh.p.k
Vlera: 54,557,097 (pesëdhjetë e katër milion e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH. | NIPT K41416033P |

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “**SENKA**” sh.p.k., me nr. NIPT-i J94808405Q, me administrator Zj.Donika Senka, i cili **nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**.
2. Operatori ekonomik “**SHENDELLI**” sh.p.k., me nr. NIPT-i K07924803N, me administrator Z.Yzedin Bozhaj, i cili **nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**.
3. Operatori ekonomik “**BEAN**” sh.p.k me me nr. NIPT-i J72510445Q, me administrator Zj. Eva Sadushi, me ofertë ekonomike me vlerë prej 51,188,491(pesëdhjetë e një milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.
Për këtë operator ekonomik Autoriteti Kontraktor UKT sh.a. mbështetur në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 13, pika 3, gërma a me anë të shkresës Nr. 14889 Prot datë 29.06.2016 ka bërë kërkesë për përjashtim nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik nga për arsye se:

Në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik "BEAN" sh.p.k. për tenderin me objekt "Rikonstruksioni i dy linjave të qendrës (Nga rruga Todi Shkurti deri te Pedonalja)" Loti II nga piketa "17" deri te piketa "33" mes të tjerash është paraqitur dhe fletë doganimit me Nr. R 24117 datë 26.03.2015, me anë të të cilit janë zhdoganuar makineritë e mëposhtëme:

- Trencher me vakum
- Trencher per hapje kanali
- Pajisje nivelues

Për fletë doganimitin e mësipërm i është kërkuar informacion Doganës Durrës, në lidhje me makineritë e zhdoganuara me shkresën Nr. 14524 Prot. datë 22.06.2016.

Kërkesës së mësipërme i është kthyer përgjigje nga Dogana Durrës me shkresën Nr. 10747/1 Prot. datë 28.06.2016, nga ku rezulton se me fletë doganimitin Nr. **R 24117** datë **26.03.2015**, nuk është zhdoganuar asnjë prej grupeve të mësipërme të makinerive, por ekskavator i përdorur New Holland komplet me nivelues 1 copë, V.P-2006.

Nga sa më sipër operatori ekonomik "BEAN" sh.p.k. rezulton se ka paraqitur dokument të falsifikuar për këtë objekt prokurimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "Kronos Konstruksion sh.p.k me me nr. NIPT-i K41416033P, me administrator Z. Vasil Jovani, me adresë: Bulevardi "Gjergj Fishta" pranë ish Ekspozitës Shqipëtare", Tiranë, me ofertë ekonomike me vlerë prej **54,557,097** (pesëdhjetë e katër milion e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, se është **identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga "5 Maji" pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.06.2016.

Ankesa: Ka ardhur ankesa Nr. 15091 Prot. Datë 04.07.2016. nga operatori ekonomik "BEAN" sh.p.k, të cilës i është kthyer përgjigje me shkresën Nr. 15091/1 datë 06.07.2016, duke mos pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

Gjatë afatit ligjor për ankesë në KPP: Është paraqitur Ankesë Nr. 15753 Prot. datë 15.07.2016 nga operatori ekonomik "BEAN" sh.p.k.

Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin Nr. 641/2016 datë 24.08.2016, ka vendosur:

1. *Të mos pranohet ankesën e operatorit ekonomik "BEAN" sh.p.k për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur" me numër Ref- 39804-05-30-2016 me objekt "Rikonstruksioni i dy linjave të qendrës (Nga rruga Todi Shkurti deri te Pedonalja)"*

Loti II nga piketa “17” deri te piketa “33”, me me fond limit 55,613,884 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 22.06.2016 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.

- 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.*